

Ekspozitë fotografish e artistes shqiptare Linda Vukaj Riccomini

Ngjyrat bardh e zi, janë ngjyrat e jetës

Linda Vukaj Riccomini, artiste shqiptare që kultivon fotografinë artistike në Itali, në një ekspozitë të hapur në Südost Europa Kultur e. V., Berlin prezanton reportazh fotografish me titull "Momentum"

Zejnullah Jakupi, Berlin

Linda Vukaj Riccomini ka lindur në vitin 1970 në Durrës, Shqipëri. Gjatë trazirave të viteve 1990-91 ajo u largua nga Shqipëria dhe emigroi në Itali për të vazhduar dhe përfunduar studimet në Univerzitetin Parma në drejtimin e fizikës. Fotografitë të momentit ajo i përmbledhi në një fotoreportazh lidhur me festivalin e Verdës në Parma dhe Busseto të cilat u botuan në librin me titull: "Sulle Ali del Vapensiero". Pasionin e saj për fotografinë ajo e zbuloi me kamerën e saj të parë e cila më pas ju be pjesa e pandashme e jetës. Ajo tani jeton në Parma ku punon si menaxhere projektesh për një portal interneti. Udhëtimet, jeta e përditshme, kushtet e punës dhe njerëzit për rreth janë motivi i saj i preferuar i temave. Fotot e saj me titull "Momentum" sqarojnë kuptimin e emërimit të ekspozitës. Nga një anë janë momentet si një matës i kohës, nga ana tjetër është impulsi i gjërave fizike në lëvizje.

Pikërisht Berlini ka qenë pikënisja e saj për të bërë ekspozitë, pasi që kjo ishte ekspozita e parë e saj. E



Linda Vukaj Riccomini

Info

Ekspozita është e hapur nga 6 qershori deri në 31 gusht 2008. ajo mund të vizitohet të hënave dhe të mërkurave nga ora 13.00 - 17.00. Vendi: Südost Europa Kultur Zentrum, Großbeerstr.88, 10963 Berlin. Tel: (030) 253779914; Fax: (030) 252 98 574. Email adresa: kultur@suedost-ev.de. www.suedost-ev.de. Lidhjet: U1 und U7, Möckernbrücke, U6 Hallesches Tor, M29 Willy-Brandt-Haus h.

gasje më njerëzore e shtetit gjerman dhe politikës së tij ndaj shqiptarëve për integrimin e tyre dhe heqjen e vizave ashtu siç po bën për serbët.

Shumica e fotografive që ka prezantuar fotografja shqiptare janë momente, që ajo ka regjistruar me aparatit e saj, "Momentet janë diçka e veçantë, ato nuk përsëriten, pra nuk janë modele, momente kur udhëtoj p.sh.etj. Përfaqësuesi i qendrës südost Europa Kultur e.V. me ndihmën e së cilës u realizua kjo ekspozitë Michael Kraft thotë se fotografitë janë mjaft të qëlluara. "Institucioni Südost Europa Kultur e. V ofron shanse të barabarta për të gjithë njerëzit nga këto rajone për prezantimin e kulturës së tyre, dhe nëse krahasohet me përmasat e prezantimit të shqiptarëve, të tjerët, popujt nga Kroacia, Serbia, Maqedonia etj, janë më shumë të prezantuar, më aktiv", por ne nuk bëjmë dallime mes popujve", thotë Kraft dhe vazhdon: Akoma shumë ngjarje kulturore që prezantohen në këtë qendër e më gjerë nuk arrijnë tek njerëzit sepse shumë pak nga ata i përcjellin ekspozitat apo kanë qasje në ngjarje të tilla, ose nuk i kushtojnë



Në hapje të ekspozitës ishte edhe Tomor Alizoti, atashe kulturor pranë Ambasadës Shqiptare në Berlin



Një fotografi e ekspozuar, punim i Lindës

pyesim se a do të kishte menduar ndonjëherë se në ekspozitën e saj të parë në Berlin do të kishte shumicën e mysafirëve, artdashësve shqiptar, nga të gjitha trojeve etnike. Ishte një fakt që e gëzonte. Falë njohjes me Mimoza Velium, poete dhe fotografe e talentuar shqiptare nga Maqedonia e cila jeton në Berlin, Lindita Vukaj kishte hapur ekspozitën në qendrën südost Europa Kultur e.V. në Berlin.

Pse pikërisht me ngjyrën bardh e zi? "Më pëlqen sepse ngjyrat bardh e zi, janë ngjyrat e vërteta të jetës", thotë Lindita dhe shprehet tutje "fotot kanë lindur bardh e zi, edhe pse nuk e ve në dyshim se më vështirë është të paraqitet arti në bardh e zi se sa me ngjyra, duhet vërtet fantazi". Ndërsa, fantazia për të zënë momente shihet se nuk i mungon fotografes shqiptare, e cila premtan se së shpejti pas kësaj ekspozite do të hap një tjetër të ngjashme edhe në Parma e gjetiu, në vendin prej nga ka ardhur për të ekspozuar. Fotografitë e Z. Vukaj janë cilësuar edhe nga publiku gjatë performancës të premtan me 6 qershor kur është hapur ekspozita. Ndërsa e pyetur se a ka në Itali artistë, piktorë, fotografë etj. shqiptarë z. Vukaj thotë se ka mjaftë, ajo ka pasur rastin të njohë shumë nga

ata dhe thotë se është ndërjet krenare për këtë fakt. Sidomos prezantimi i artit përmes Videoinstalacionit për fotografen vitin e kaluar në bienalen në Itali ishte diçka e mrekullueshme.

Fotografja shqiptare ka vite që jeton në Itali ku edhe ka studiuar. Ajo është angazhuar në shumë projekte, ka botuar shumë fotografi të momentit si reportazhe etj. "Momentet, janë diçka të papërsëritshme, andaj edhe vrojtimi i tyre të emocionon, thotë Eva Gjoni studiuese në specializim në fushën e psikoterapisë në Berlin. "Më kanë pëlqyer fotografitë, sepse edhe jeta jonë është një mbledhje momentesh. Më pëlqen po ashtu pikëpamja estetike, shumë të bukura i uroj shume sukses".

Në ekspozitë ka marrë pjesë edhe Tomor Alizoti, atashe kulturor pranë Ambasadës Shqiptare në Berlin, Armand Plaka gazetar i gazetës Shqip që po përcjell një projekt të gazetarisë investigative në Berlin bashkë me gazetarë të vendeve të Lindjes dhe të rajonit. Z. Plaka i vlerëson aktivitetet e tilla kulturore dhe thotë se në këtë drejtim, duhet të ecë edhe politika dhe shkëmbimi i informacionit nga vendet e Evropës perëndimore në drejtim të Shqipërisë e Kosovës, një shkëmbim edhe kulturor, por edhe një hapje, një

jinë fare rëndësi. E njëjta vlen edhe për interesimin e medieve gjermane lidhur me këto tema. Kur në Berlin kemi brenda ditës mbi 3000 ngjarje kulturore, shfaqje, ekspozita atëherë shumë rrallë ndonjë nga gazetarët gjermanë e merr mundin të shprehë interesim për të ndjekur ngjarjet e tilla, siç janë prezantimi i artit, letërsisë, pikturës, etj nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, thotë nder tjerash z. Kraft.

Z. Kraft falënderon edhe interesimin tonë, të gazetës Zëri i Ditës për raportim. Ndërsa ne, duke ditur se vërtet kjo qendër tani për tani është çerdhja e vetme ku bëhet prezantimi i kulturës, artit dhe letërsisë nga rajoni, i duhet thënë një "danke schön" qendrës Südost Kultur e. V. Pa mëdyshje se kjo qendër ka bërë më shumë se çdo institucion shqiptar këtu në Berlin, për të prezantuar kulturën tonë së paku për qytetarët, gjegjësisht publikun gjerman dhe artdashësit e të gjitha kulturave pa dallime nacionaliteti, bindjeje politike, përkatësie religjioze etj, për një njohje mes veti dhe zhvillim të komunikimeve në këto sfera. Është për tu dëshiruar që një ditë, dy shtetet tona të kenë arritur nivelin e ndërmjetësimit, pranë shteteve dhe të jeme më aktiv edhe në fushën të kulturës.

Më 14 qershor në Thun

Mbahet mbledhja e LAPSH

Lidhja e Arsimitarëve dhe e Prindërve Shqiptarë "Naim Frasheri" në Zvicër dhe Këshilli nis-mëtar në Thun i fton të gjithë prindërit shqiptarë të Thunit me rrethinë që doemos të marrin pjesë në mbledhjen e datës 14. 6. 2008, në ora 15 që do të mbahet në lokalitetin e klubit në Shtefisburg. Me këtë rast do të zgjidhet kryesia e këshillit të prindërve dhe do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga kryesia qendrore e LAPSH-it në Zvicër.

Ky takim është me interes të veçantë për përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve tanë në mësimin



Nxënës të shkollës me mesim plotësues në gjuhën shqipe në Thun

plotësues shqip. Për informata, mobil 078 88 67 881 / 078 81 720 39 Për Këshillin iniciues në Thun, Mefail Selmani

Nga Shoqata Kulturore "Hasi" në Berlin

Tubim me moton: Ndhimë për Besartën

Të nderuar Bashkatdhetarë dhe Bashkatdhetare! Besarta Hodaj jeton me familjen e saj tash 15 vite në Berlin. Aktiviste e dalluar, valltare e shkëlqyeshme dhe nxënëse shembullore e gjimnazit Ernst-Reuter-Oberschule (nota mesatare 1.1) e gatshme që në çdo kohë të ndihmojë pa marrë parasysh kombësinë, fenë, racën ajo njeriun e quante njeri dhe e zgjedh edhe drejtimin që me të vërtet t'i ndihmojë njeriut, atë të mjekësisë. Mirëpo për fat të keq atëherë kur ajo po përgatitej që me sukses shembullor ta përfundonte abiturën dhe t'i vazhdonte studimet nga një kontroll mjekësor u diagnostifikua sëmundja e rëndë Leukemia e cila përkohësisht e ndau nga shokët dhe shoqet e klasës (gjimnazit) nga aktivitetet e lira dhe nga mësimi që ajo aq shumë e dëshironte.

Për shërimin e kësaj sëmundje duhet të gjendet një dhurues vull-

netar i tipizimit të qelizave embrionale (Stammzelle), deri me sot janë paraqitur me qindra e mijëra vullnetarë mirëpo personi adekuat ende nuk është identifikuar. Sipas udhëzimit të mjekëve shanset më të mëdha për gjetjen e qelizave embrionale (stammzelle) adekuate ekzistojnë te personat me prejardhje të njëjtë nacionale (në rastin konkret te shqiptarët).

Për këtë arsye Shoqata Kulturore „Hasi“ në Berlin organizon një tubim me moton

"Ndhimë për Besartën"

Tubimi do të mbahet të shtunën me 14.06.2008 duke filluar në orën 15⁰⁰ h në lokalet e shoqatës Trep-tower Straße 68,12059 Berlin-Neukölln. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni edhe në këta numra telefoni

0176 96304228 Ymer Duraku, 0171 6837651 Bujar Nezaq

Komisioni për informim i shoqatës

St. Gallen

"Iliria" merr pjesë në festën e Wattwilit

Më 14. edhe 15. qershor 2008 në Wattwil mbahet festa tradicionale "Festa e Wattwilit" ku marrin pjesë 34 shoqata të kësaj qyteze. Në mesin e tyre do të jetë edhe SH.K.SH ILIRIA e cila do të prezantohet me program artistik: valle popullore, me 14.06.2008 prej orës 12:45 deri 13:30, si dhe me specialitete nga kuzhina shqiptare. Pjesëmarrja sa më e gjerë e komunitetit shqiptar është e mirëseardhur, sepse nderon dhe madhëson këtë feste dhe shoqatën tonë.

SH.K.SH ILIRIA

Në organizim të FC Prishtina Bernë më 21-22 qershor Turnir tradicional ne Futboll të vogël

FC Prishtina Bernë, më 21 dhe 22 qershor organizon turnirin në futboll të vogël në Fushën Viererfeld, Bernë. Turniri luhet në sistemin 5+1 lojtarë. Ditën e parë, më 21 qershor 2008 turniri fillon nga ora 9.00 (mëngjes) dhe luhet deri në orët e vona, ndërsa të dielën, më 22 qershor ndeshjet fillojnë nga ora 8.00.

Afati i fundit i paraqitjes është më 15 qershor. Paga është 120 Fr. kurse për juniorët 80 Fr. Paraqitjen e ekipeve mund ta bëni nëpërmes kontos, FC Prishtina, Postfach 213 3000 Bern 22 Konto: Nr. 60-684317-8 Informatat: Tel. 079 291'09'52 Besim Fejza ose Skender Halili 076 328 91 00 Islam Ramadani 079 625'43'20 në e-mail info@fcprishtina.ch Gjatë zhvillimit të turnirit do të sigurojmë edhe një televizor për ndjekjen e lojërave të Kampionatit Evropian.

Në Mannheim, Gjermani

Mbahet turniri "DARDANIA-CUP'08"

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se më datën 15.06.08. Sh.K.Sh. "Dardania" në Mannheim organizon turnirin tradicional në futboll të vogël-DARDANIA-CUP`08. Për informata në tel.0173/7025421 & 01726052081 ose në E-mail www.dardania-ma.com.

Turnir në futboll

Shoqata Kulturore Kombëtare "MALËSIA" në Hechingen organizon turnir në futboll të vogël (5+1). Ky turnir organizohet për nder të Ditës së Çlirimit të Kosovës. Njoftojmë të gjithë Klubet shqiptare, Shoqatat dhe të interesuarit tjerë, dashammirë të futbollit se paraqitja e ekipeve bëhet prej orës 9-10 dhe kushton 30 Euro. Turniri mbahet të dielën, me 15.06.2008 në Fushat e sportit në Zollern strasse në Hechingen. Për çdo informata në këta numra telefoni: 01628317530 dhe 015203532495.

Mirë se vini.

Shoqata Kulturore Kombëtare "MALËSIA" Hechingen.

Në Albstadt kremtohet dita e çlirimit

Klubi Shqiptar! Shqiponja në Albstadt, për nder të 12 qershorit, Ditës së Çlirimit të Kosovës, organizon tubim festiv me datën 14.06.2008 të shtinën, duke filluar në orën 18.00 në këtë adresë: Turn-Fest hale në Albstadt-Pfaffingen (afër shkollës Hauptschule). Organizatori për të pranishmit ka përgatitë një program të pasur kulturor-artistik.

Ejani të festojmë së bashku.

Mirë se vini.

Kryesia e Klubit